

7 причини да не се користи пластика за една употреба?



Prodhoet prej
lëndëve djegëse fosile



Ka gjurmë jashtëzakonisht
të madhe të karbonit



Qeset plastike
riciklohen me përqindje
të papërfillshme



Edhe pas qindra vitesh
ende do të jetë këtu



I vret kafshët
dhe shpezët



Depërton në zinxhirin
tonë ushqimor



I ndotë hapësirat e ujit

Për më tepër këshilla për të drejtat tuaja si
konsumatorë, mund të kontaktoni
Organizatën e Konsumatorëve të Maqedonisë,
ZKM - Shkup, tel. 02/3 179 592 ose
nëpërmjet faqes së internetit
www.opm.org.mk
e-mail: sovetuvanja@opm.org.mk

**KËSHILLI PËR MBROJTJE TË KONSUMATORËVE
I QYTETIT TË SHKUPIT ME PROGRAMIN E VET
E MBËSHTET MBROJTJEN E KONSUMATORËVE**

Qyteti i Shkupit



**COBET ЗА ЗАШТИТА
НА ПОТРОШУВАЧИТЕ**

**KËSHILLI PËR MBROJTJE TË KONSUMATORËVE
I QYTETIT TË SHKUPIT
Bul. Ilinden nr. 82 - Shkup**



Qyteti i Shkupit



**COBET ЗА ЗАШТИТА
НА ПОТРОШУВАЧИТЕ**

KONSUMATORË

TA MBROJMË
MJEDISIN
JETËSOR
DHE T'I THEM **JO**
QESHEVE
PLASTIKE DHE
PLASTIKËS PËR NJË
PËRDORIM!

- Të veprojmë kundër përdorimit dhe shpërndarjes së qeseve plastike!
- Të luftojmë kundër varësisë nga paketimet plastike që përdoren vetëm një herë!
- Të aplikojmë zgjidhje që janë miqësore ndaj mjedisit!



SI TË MBETEMI KONSUMATORË TË PËRGJEGJSHËM?

Vetëm me disa veprime të thjeshta mund të zvogëlojmë MBETURINAT QË I KRIJOJMË NE:

- Të përdorim torba për përdorim të shumëfishtë!
Torba prej pëlhurave (të vogla dhe të mëdha): janë të lehta për t'u transportuar, nuk zënë vend dhe mund të lihen kudo që t'i kemi "pranë dore": në shtëpi, në makinë, në çantën e shpinës ose në çantë.
- Në supermarket, dyqan ose treg të themi "JO", kur na ofrojnë qese plastike dhe të përdorim torbën tonë për përdorim të shumëfishtë.
- Gjithmonë me vete të mbajmë nga një shishe me formë dhe madhësi - sipas nevojat tona personale, ashtu që gjithmonë të kemi ujë "afër dorës" me çka do të kursejmë edhe para edhe mbeturina.

- Të përdorim kavanoza: për pije (kos, qumësht, smuthi, kafe), për të mbajtur pasta, orizi, sheqer, krip etj. Kavanozat mund t'i përdorim më shumë herë për të ruajtur ushqimin dhe pijet.
- Kur pimë kafe, lëng ose smuthi të theksojmë se nuk kemi nevojë për kashtë.
- Gjithmonë të kemi një takëm për të ngrënë me vete, ashtu që kur të porositim ushqim që do ta marrim me vete të mos përdorim takëm për vetëm një përdorim, ndërsa kur përgatitemi për dalë në natyrë me miqtë, mund të marrim takëm dhe enë për përdorim të shumëfishtë.
- Të përpiqemi të blemë produkte pa ambalazh fare ose me shumë pak ambalazh. Kjo donë të thotë se duhet të blemë refus dhe të kemi me vete kavanoza, torba ose kanoçe deri te dyqani. Dhe, gjithsesi, sa më shumë që mundet të shmangim paketimin e dyfishtë që më së shpeshti përdoret nga industritë për ëmbëlsira, kos dhe ushqim të ngrirë.



Ndotja e mjedisit jetësor me plastikë

Stili bashkëkohor i jetesës imponon shfrytëzim të produkteve për një përdorim siç janë qeset, shishet, gotat, pjatat dhe takëmet të gjitha prej plastike, paketime plastike etj. Akumulimi i këtyre produkteve rezulton me ndotje me plastikë në mbarë botën. Meqenëse plastika përmban ndotës toksik dhe nuk është i biozbërthyeshëm, ajo ka potencial t'i shkaktojë dëm të madh të mjedisit jetësor duke e ndotur ajrin, ujin dhe tokën (në nivel makro dhe mikro).



Efektet kryesore afatgjate të ndotjes me plastikë:

- Ndikim mbi zinxhirin ushqimor
- Ndotje e ujërave nëntokësore
- Ndotje e tokës (ndotje nëntokësore dhe mbitokësore)
- Ndotje e ajrit
- Dëme të përhershme ndaj ekosistemeve (vret kafshë)
- Probleme shëndetësore te njerëzit - plastika është helmuese
- Ndikime negative ekonomike dhe sociale